



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 978 prot.

Tiranë, më 29. 06. 2022

V E N D I M

Nr. 130, datë 29. 06. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² shqyrtoi ankesën nr. 182, datë 07.10.2021, të shtetasit A. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e shtetasit A. V., Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër³.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, shtetasi A. B., në mes të tjerash informon se: “Unë, A. B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, ju informoj që i kam bërë kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorit të Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit të ngrenë Komisionin e Disiplinës për Drejtorin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, A. V. dhe Specialistin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, N. S.

Drejtori A. V., me specialistin N. S., më kanë fyer dhe më kanë goditur në ambientet e institucionit. Ngjarja ka ndodhur pasi drejtori disa minuta përpara se të niste konfliktin me mua kishte bërë debate me dy ish punonjës, ku unë nuk isha prezent pasi kam qenë në zyrën time. Menjëherë pasi kam dëgjuar zhurmën kam dalë nga zyra duke ndërhyrë për ti ndarë (pasi drejtori ishte duke u kacafytur me ish shoferin e institucionit pasi nuk e lejonte të merrte një

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër

dokument në protokoll i cili i duhej për punët e tij, njëkohësisht drejtori po bërtiste e ulëriste edhe me ish drejtuesin e inspektoratit).

Pasi mora ish shoferin dhe e shoqërova jashtë, kthehem për në zyrë por aty ndeshem me ironitë e drejtorit, në atë kohë i shkoj në zyrë dhe i them mos më ngatërro mua me këtë histori se skam lidhje dhe ti nuk mund të ndalosh njeri i cili ka nevojë për shërbimin tonë, sepse zyrat janë në shërbim të gjithë atyre që u nevojiten dhe ti s'ke të drejtë ti ndalosh dhe aq më keq ti tërheqësh zvarrë. Menjëherë pas kësaj që i thashë drejtori më akuzon përsëri duke mu drejtuar, i di unë të gjitha ça bën ti, po mos ki merak se do ta shohësh se ç'kam për të bërë. Duke parë situatën që ishte shumë e tensionuar nuk reagoja dhe dola te dera duke ndezur një cigare.

Drejtori mbylli derën e tij dhe del jashtë, kur më pa te dera, më flet me ton të lartë për një e-mail që unë kisha mbaruar punë që në mëngjes, kur e mori përgjigjen, nuk i pëlqeu dhe më thotë: Pse nuk rri në zyrë? Unë i përgjigjem se po pi një cigare pasi nuk mund ta pi në zyrë. Atëherë, ai ma përsërit prapë, mirë mirë se ta tregoj unë ty. Atëherë unë i them, mos fol duke bërtitur dhe në distancë, por po ke gjë hajde futemi në zyrë dhe sqarohemi, jo sikur jemi në pyll. Në këtë moment më afrohet, ah dashke në zyrë ti, hë, dhe me godet. Në kohën që unë do reagoja ndaj goditjeve me grushta dhe shqelma nga drejtori, një person më kap nga mbrapa dhe më mban të lidhur me duar, kur ndërkohë drejtori vazhdon të qëllonte, menjëherë ka ndërhyrë punonjësi G. Zh. që ishte aty duke sprapsur drejtorin.

Pasi jam liruar nga personi që më mbante nga mbrapa i afrohem drejtorit, por ai u sul duke më qëlluar edhe një herë me shqelm, në atë moment unë u rrëzova. Pastaj erdhën të gjithë punonjësit e institucionit të cilët ndërhyjnë duke e larguar atë. Kjo ishte e gjithë ngjarja që ndodhi në lidhje me drejtorin.

Pasi nuk po e ndjeja veten mirë, shkoj në urgjencë duke marrë mjekim dhe bëra grafi për arsye se kisha shembje në të gjithë trupin, nofullën e djathtë dhe dorën e majtë, të cilat janë evidentuar nga mjekoligjori, mjeku i lagjes dhe mjeku i urgjencës.

Drejtori i institucionit kërkon medoemos të më largojë nga vendi i punës pasi disa herë më ka kërkuar dorëheqjen për arsye se shprehet se ke aderuar në Partinë Socialiste për Integrim (LSI) dhe nuk ke aderuar me Partinë Socialiste (PS).

Në Facebook ka gjetur një adresë me emrin Goni Futboll të cilën nuk e disponoj dhe manaxhoj unë. Aty ka nxjerrë postime dhe foto ku unë kam qenë prezent dhe më ka çuar në Komision Disipline për arsye sikur unë kam marrë pjesë në Fushatën Zgjedhore 2021. Kjo nuk është e vërtetë pasi këtë faqe e menaxhon dikush tjetër dhe atë foto nuk kanë lidhje me Fushatën Zgjedhore të vitit 2021.

Gjatë kësaj kohe drejtori A. V. vazhdon me provokime, ofendime, presione dhe deri sa situata u agravua në dhunë fizike.

Më akuzon që kam munguar në punë dhe kam marrë pjesë në fushatë kur ndërkohë unë nuk kam asnjë mungesë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit sa i përket sjelljes së A. V. ndaj tij, si dhe ndër të tjera: “

- a) *Mbrojtjen e dinjitetit, personalitetit dhe figurës time si punonjës në shërbimin civil.*
- b) *Të punoj në një mjedis të qetë dhe të sigurtë dhe jo në një presion psikologjik të vazhdueshëm që e kam ndeshur gjithë këtë periudhë. Ku presioni i vazhdueshëm ka degraduar në dhunë fizike të drejtorit kundrejtë meje, brenda institucionit, në prezencën e gjithë punonjësve. Për këto arsye kam bërë kallëzim në Policinë Fier dhe në Prokurori.*
- c) *Drejtori A. V. nuk i plotëson kriteret për të qenë punonjës në shërbimin civil sepse presionin që ushtron nuk e bën vetëm ndaj meje por edhe ndaj shumë prej punonjësve që punojnë në këtë institucion.*
- d) *Shumica e punonjësve ndihen të kërcënuar prej tij, por nuk e denoncojnë pasi ai u bën presion vazhdimisht për heqje nga puna.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁴, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

⁴ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “bindjet politike”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e bindjeve politike të tij.

Neni 91, pika 3 e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se: “3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 182, datë 07.10.2021, të bërë nga A. B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo nuk i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, me anë të e-mail-it datë 18.10.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i është drejtuar subjektit ankues duke i kërkuar informacion shtesë për plotësimin e ankesës.

Në përgjigje përsa sipërcituar, ankuesi me anë të e-mail-eve datë 25 dhe 26.10.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit, informacion dhe prova shtesë për plotësimin e ankesës së paraqitur pranë KMD-së.

2. Pas plotësimit të ankesës nga A. B., në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nëpërmjet shkresës nr. 1406/1 prot., datë 01.11.2021, Komisioneri i është drejtuar Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues dhe duke i përcjell një kopje të ankesës.

Në përgjigje të shkresës⁵ së sipërcituar, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë me shkresën nr. 3972 prot., datë 08.11.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Përsa i përket pikës a) dhe shpjegimit të situatës nga ana e shtetasit dhe nëpunësit A. B., sipas versionit të tij, deklaroj me bindje të plotë dhe me përgjegjshmëri se paraqitja e situatës është e pavërtetë, e gjithë deklarata është një shpifje, mashtrim dhe deformim i fakteve

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1406/2 prot., datë 11.11.2021

dhe të vërtetës. Të gjithë situatën e ndodhur dhe rrjedhën e ngjarjeve do ti gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese, material i cili i është vënë në dispozicion Komisionit Disiplinor të ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ndaj nëpunësit A. B., komision i cili është ende në proces. Theksoj se bashkëlidhur do të gjeni jo vetëm ngjarjen e vërtetë nga unë si Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i mbajtur me Proces Verbal, i datës 08.09.2021, dita në të cilën ka ndodhur ngjarja që po trajtohet, por edhe materialin e mbajtur nga nëpunës të tjerë të Institucionit, të cilët kanë qenë prezent në ngjarjen e ndodhur, ku materiali i është vënë në dispozicion Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit E. K., nga punonjësit e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

Gjithashtu do të gjeni deklaratën e nëpunësit N. S., i cili paraqet po ashtu ngjarjen e vërtetë, si dëshmitar kryesor, dhe si personi i atakuar, i cili ka marrë goditje në trup nga nëpunësi A. B., për të cilat disponon edhe fotografi të dëmtimeve që ka pësuar të cilat po jua vendosim në dispozicion. Materiali i është përcjellë dhe vënë në dispozicion edhe Komisionit Disiplinor të ngritur ndaj nëpunësit A. B.. Ju ftoj të njiheni me të vërtetën, në bindjen time dhe jo vetëm, në të gjitha këto materiale të lartpërmendura të cilat i gjeni bashkëlidhur duke ju lënë të kuptoni dhe evidentoni faktin e thjeshtë se nuk është rastësi që situata dhe përshkrimi i ngjarjes i treguar nga 7 persona (punonjës të Institucionit dhe dëshmitarë të ngjarjes) është i njëjti, përkundrejt versionit të një personi të vetëm A. B., i cili kërkon të deformoj dhe shmang verprimet e rënda dhe skenën që ka shkaktuar...

Përsa i përket pikës b), ju informoj se përveç se është një pretendim absurd, qesharak, është gjithashtu i pavërtetë dhe i pabazuar në fakte. Jam i hapur ndaj çdo lloj fakti, dhe prove që dëshmon vërtetësinë e këtij pretendimi duke ju thënë se nëse do të ishte i vërtetë, punonjësi A. B. do ta kishte ngritur si shqetësim dhe do kishte paraqitur ankesë pa më të voglin dyshim, duke ju drejtuar Juve, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Për këtë mund ti drejtoheni Institucionit Epror (AKM), nëse pranë tyre është përcjellë ndonjë shqetësim (Ankesë/Kërkesë) e tillë nga ky punonjës apo edhe çdo lloj ankese tjetër nga punonjës të tjerë ndaj meje si Drejtues.

Përsa i përket pikës c), bashkëlidhur do të gjeni materialin e mbajtur për faktin në fjalë, në kohën kur është evidentuar shkelja e bërë nga punonjësi A. B.. Theksoj se evidentimi i faqes Facebook nuk është bërë nga unë dhe nuk është bërë për pretendimin se punonjësi në fjalë ka marrë pjesë në fushatën zgjedhore. Punonjësi në fjalë, nëpërmjet adresës së tij personale në Facebook ka shprehur hapur bindjet e tij politike, gjatë orarit zyrtar të punës, për më tepër në një periudhë parazgjedhore, gjatë së cilës çdo punonjës ka qenë në monitorim nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Të gjitha faktet janë evidentuar dhe vërtetuar nga grupi i Monitorimit, ku më pas janë paraqitur tek unë, dhe së bashku me verifikimet e mia, i gjithë materiali i është dërguar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke qenë përpara faktit të shkeljes së nenit 37, pika 1 të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil"...

Përsa i përket pikës d), ndaj punonjësit në fjalë nuk është ushtruar kurrë asnjë formë presioni, ofendimi apo provokimi. Punonjësit i është kërkuar vetëm të kryej detyrën e tij funksionale, detyrë në të cilën ky punonjës lë shumë për të dëshiruar, të faktuara këto edhe me

gjithë praktikat e punës të perealizuara nga ana e tij. Por i gjendur përballë paaftësisë së tij për të përmbushur detyrat e tij funksionale dhe mungesës së justifikimit të kësaj paaftësie, punonjësit nuk i mbetet gjë tjetër veçse të shpifi dhe të bëjë deklarata të tilla të rreme, të pavërteta dhe të pabazuara në asnjë fakt apo provë.

Përsa i përket pikës e), mungesa e një dite e pajustificuar e punonjësit A. B. është evidentuar po ashtu nga grupi i monitorimit të ngritur gjatë kohës së periudhës parazgjedhore dhe gjithashtu edhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëpërmjet listë-prezencave me të cilat ne raportojmë pranë tyre në këtë periudhë, ku çdo lëvizje gjatë orarit zyrtar duhej të ishte e pasqyruar dhe justifikuar. Pretendimi i punonjësit nuk është akuzë, por është fakt, material të cilin po ashtu e gjeni bashkëlidhur...

Lidhur me kërkesat e tjera që punonjësi i parashtron Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të kishte qenë shumë më e lehtë dhe një fitore për të gjithë, nëse ky punonjës do të ishte kujdesur vetë për ruajtjen e dinjitetit të tij, personalitetit, dhe figurës së tij prej nëpunësi civil. Ndërkohë që gjithçka që ka bërë ky punonjës ka qenë denigrimi i figurës së tij me veprime aspak të hijshme për një nëpunës civil. E quaj qesharake dhe për të ardhur keq, faktin që kërkohet mbrojtja e dinjitetit nga një punonjës që konsumon alkol gjatë orarit të punës (fakt ky që e ka pohuar dhe vetë pikërisht gjatë ditës së ngjarjes së parashtruar), i paraqitur edhe në materialet që do ju vihen në dispozicion, nga një punonjës që kërkon një mjedis të qetë për të punuar, ndërkohë që ky punonjës ka kontribuar vet në krijimin e një mjedisi pune aspak të qetë dhe aspak të denjë për një administratë, duke shqetësuar dhe terrorizuar gjithë institucionin me sjelljen e tij dhe dhunën fizike që ka ushtruar ndaj meje si drejtues dhe ndaj punonjësit N. S. në datën 08.09.2021, nga një punonjës që ditën e tij të punës e kalon duke luajtur në kompjuter dhe në telefon, apo në bare dhe lokale duke konsumuar alkol, duke bërë gjithçka tjetër përveçse përmbushjen e detyrave të tij funksionale.

Përveç të tjerave, punonjësi A. B. ka një mungesë të theksuar në realizimin e detyrave të tij, në respektimin e afateve, në hartimin e një shkrese të thjeshtë zyrtare, për mos të folur më pas për krijimin e një detyre në Excel, apo edhe detyra të tjera, njohuri të cilat tek punonjësi nuk ekzistojnë, dhe është për të ardhur keq, kur këtë paaftësi e ndesh në një punonjës me pozicionin e Përgjegjës dhe me pozicionin ish-Drejtues i ISHMPUT Fier. Punonjësi A. B., gënjen haptazi dhe vendos në vështirësi dy specialistët e sektorit të tij, të gjitha këto praktika të mbajtura gjatë kohës, me të cilat mund të njiheni bashkëlidhur...

Lidhur me pretendimet e ngritura për figurën time si nëpunës civil dhe si Drejtues Institucioni, kam bindjen se puna ime në këtë institucion flet më shumë se çdo fakt, dhe me modesti mund të shprehem se gjithçka kam bërë ka qenë ngritja dhe lartësimi i figurës së nëpunësit civil dhe figurës së Drejtuesit. Në të gjithë eksperiencën dhe punën time disa vjeçare në administratën publike në pozicione Drejtuese, mbi të cilën nuk hedhin dotë baltë disa persona që nuk e kanë vendin në Administratën Publike, me gjithë përgjegjësitë që rrjedhin nga të qënurit pjesë e saj, si dhe që prej ditës së parë të detyrës time si Drejtor në këtë Institucion kam patur frymën e bashkëpunimit të plotë, tolerancës dhe mirëkuptimit, duke i dhënë gjithsecilit hapësirën e nevojshme për të bashkëpunuar dhe shprehur idetë e tyre.

Parimet e mia të patundura dhe marrëdhënia Epror-Vartës që kam ndërtuar me punonjësit e mi ka patur impaktin e saj të dukshëm në realizimin e mirë dhe korrekt të një sërë detyrash dhe objektivash. Pranë ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, gjatë kohës që unë drejtoj këtë Institucion, janë punësuar nga Programi i Ekselencës dhe jo vetëm, punonjës të rinj që sapo kanë përfunduar studimet, dhe kontakti i parë me administratën publike ka qenë pikërisht me Institucionin që unë drejtoj, ndaj ju ftoj të kontaktoni me ta dhe të informoheni, si persona të pandikuar nga asnjë lloj situatë, në lidhje me perceptimin e tyre ndaj punës time si Drejtues, në lidhje me frymën e punës që kanë hasur që prej ditës së parë që janë emëruar pranë ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë dhe gjithashtu nëse janë ndier në ndonjë moment të kërcënuar, presionuar apo provokuar për vendin e punës nga unë si Drejtues, jo vetëm ata por edhe çdo punonjës tjetër i Institucionit...

Në përfundim, dëshiroj të shtoj se, me bindje dhe me krenari mund të them se parimet e mia, fryma e bashkëpunimit dhe mënyra ime e të punuarit me korrektësi, produktivitet dhe ligjshmëri janë përqafuar më së miri nga një pjesë thelbësore dhe e aftë e Institucionit. Pjesa tjetër, si punonjësi në fjalë A. B., e gjen të vështirë të përshtatet me Ligjin, Rregulloren, Kodin e Punës dhe Etikës, Disiplinën, me përgjegjësinë e detyrës funksionale, me realizimin e detyrave dhe objektivave, dhe për këtë arye degradojnë në situata dhe deklarime të tilla.”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë vuri në dispozicion të KMD-së:

- Kopje të vlerësimeve të punës 6 mujori i dytë i 2020, 6 mujori i parë i 2021;
 - Kopje të procedurës së ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me A. B.;
 - Kopje të akteve të dy viteve të fundit, largime, masa disiplinore të tjera ndaj punonjësve të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë dhe kopje të akteve për punonjës të tjerë që nuk kanë qenë prezent gjatë kontrolleve.
3. Në vijim me anë të e-mail-it datë 09.11.2021, ankuesi sqaroi ndër të tjera Komisionerin se: “...ditën e parë që jam kthyer në punë, pas mbarimit të raportit shëndetësor, pasi kam probleme shëndetësore, më janë vënë në dispozicion me e-mail 6 procesverbale të firmosura vetëm nga drejtori i institucionit dhe jo të mbajtura me komisionin sipas procedurave ligjore. Këto procesverbale më janë vendosur në dijeni në datën 01.11.2021 kur procesverbalet sipas tij janë mbajtur që nga shtatori, pra datat janë në procesverbale dhe dyshoj që mund të jenë falsifikuar datat në protokoll pasi po të ishin shënuar në datat përkatëse do të kisha marrë njoftimin po në atë datë.”

Gjithashtu, A. B. informoi se ndaj tij vijon të ushtrohet presion duke iu kërkuar nga drejtuesi i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, të hartojë informacione, ndërkohë që ankuesi nuk ka bazë materiale, kompjuter.

4. Me anë të e-mail-it datë 19.11.2021, Komisioneri vuri në dispozicion të subjektit ankues parashtrimet e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Në përgjigje të tyre me anë të e-mail-it datë 22.11.2021, ankuesi parashtroi pretendimet e tij dhe sqaroi ndër të tjera se:

“...Për sa i përket pretendimit të drejtorit që unë kam goditur punonjës të N. S. është çdo gjë shpifje dhe gënjeshtëri dhe shpresoj t’ju vendosë në dispozicion qoftë edhe një provë të vetme. Në dijeninë time N. S. nuk është paraqitur asnjëherë në spital se nuk ka qënë personi i dëmtuar, por ai person kam qënë unë (verifikohet lehtësisht nga regjistrat e urgjencës)...

Nëse do të pyeten të gjithë punonjësit të jeni të bindur që do të merrni përgjigjen e kërkuar (të ruhet anonimati) për presionin që ky drejtues ushtron.

Në lidhje me pikën c), është lehtësisht e verifikueshme pasi drejtori A. V. ka kërkuar ngritje të komisionit në lidhje me pjesëmarrjen time në fushatë.

Në lidhje me pikën d) që personi im nuk realizon detyrat sipas kërkesave të tij absurde. Përpara se të ndodhte debati si ka mundësi që unë nuk kam patur asnjë vërejtje nga drejtori ku të gjitha vlerësimet i kam Shumë Mirë. Por sapo ndodhi konflikti midis meje, drejtorit dhe specialistit më ngarkonte me detyra ku e dinte shumë mirë që mua më mungonte baza materiale (kompjuter) dhe në këtë kohë i jep leje të zakonshme specialistes sime pa dijeninë time si epror direkt i saj, pasi kjo e fundit kishte të gjithë informacionet për çdo kontroll apo komunikim që kemi realizuar me institucionet e tjera. Çdo gjë që unë kam shkruajtur verifikohet lehtësisht nga protokoll i institucionit. (bashkëlidhur e-mali që i kam dërguar specialistes V. G. e cila nuk ka denjuar të më konfirmojë marrjen e e-mailit). Si ky rast janë të gjitha procesverbalet e mbajtura nga drejtori kundrejt meje.”

5. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 95 prot., datë 13.01.2022 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 25.01.2022. Për shkak të pamundësisë⁶ së realizimit të seancës dëgjimore në këtë datë, me shkresën Nr. 312 prot., datë 14.02.2022, u vendos realizimi i saj më datë 23.02.2022.
6. Më anë të e-mail-it datë 21.01.2022, ankuesi informoi Komisionerin se menjëherë sapo punëdhënësi është njohur me shkresën e KMD-së për realizimin e një seance dëgjimore, është njoftuar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për t’u paraqitur në Komisionin Disiplinor të ngritur referuar kërkesës së drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë kundrejt ankuesit.

⁶ Si rezultat i gjendjes shëndetësore të përfaqësuesve të KMD-së, së shkaktuar nga Covid-19.

7. Sipas njoftimit Nr. 312 prot., datë 14.02.2022, seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, A. B. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 1251 prot., datë 21.02.2022, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, B. B., me detyrë Përgjegjëse Sektori e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Gjithashtu, deklaroi ndër të tjera se gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, punonjësit e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër kanë firmosur 4 (katër) herë në ditë gjatë orarit zyrtar të punës për efekt të prezencës në punë të nëpunësve civil. Ankuesi informoi se përpara se të niste fushata zgjedhore marrëdhëniet me punëdhënësin i ka patur korrekte dhe nuk është ndier i diskriminuar. Pasi nisi fushata zgjedhore, sipas tij, nga ana e punëdhënësit i është kërkuar të dorëhiqet nga pozicioni i punës për shkak se ka qenë pjesë e strukturave Partinë Socialiste për Integrim (LSI) dhe nuk ka aderuar në Partinë Socialiste (PS). Duke qenë se nuk ka pranuar të jap dorëheqjen, atëherë ndaj tij kanë nisur veprimet diskriminuese është ngritur komision për dhënie mase disiplinore. Në vijim ankuesi deklaroi se pas ankimit të Komisioneri, sjellja diskriminuese e shtetasit A. V. ndaj tij është përkeqësuar.

Përfaqësuesja e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, i qëndroi parashtrimeve të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe deklaroi se për ankuesin është ngritur një komision disiplinor, referuar kërkesës së ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër. Komisioni ka trajtuar 4 (katër) shkelje të pretenduara nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër për ankuesin. Nga analiza e bërë, komisioni nuk konstatoi pretendimin e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, sa i përket: shprehjes së bindjeve politike në rrjetin social Facebook nga ankuesi; mungesën e pajustificuar të tij deri në 3 (tre) ditë gjatë muajit Prill 2021 dhe shkeljen e përsëritur të rregullave të etikës. Komisioni konstatoi shkelje vetëm sa i përket pretendimit të problematikave në hartimin dhe cilësinë e shkresave të hartuara nga ankuesi gjatë ushtrimit të detyrës. Për këtë, ankuesit iu dha masa disiplinore “mosngritje në detyrë deri në 2 vite”.

Sa i përket masës disiplinore të dhënë nga ana e AKM-së, ankuesi theksoi se për të gjitha pretendimet e ngritura nga ana e drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, ai është njohur më datë 21.10.2021 dhe nuk e kishte informacionin për të kundërshtuar argumentat e parashtruar nga përfaqësuesit e komisionit. Gjithashtu, ankuesi theksoi se komisioni disiplinor nuk e mori parasysh këtë fakt dhe vijoi me dhënien e masës disiplinore ndaj tij.

Në vijim, përfaqësuesja e AKM-së theksoi faktin se ankuesi gjatë ushtrimit të detyrës së tij, është vlerësuar nga punëdhënësi me 2 (dy), mirë. Në vlerësimin e fundit, nga ana e drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, ankuesi është vlerësuar me 4 (katër), “Jo kënaqshëm”, por ky vlerësim

nuk është miratuar nga ana e drejtuesit të AKM-së, me arsyetimin se ka ndodhur pas konfliktit mes dy punonjësve. Më pas ndaj ankuesit është marrë vlerësimi sërish me 2 (dy), “Mirë” edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2021.

Në përfundim nga ana e përfaqësueses së AKM-së u theksua se edhe për drejtuesin e ARM-së Fier/Vlorë/Gjirokastrë është ngritur një komision disiplinor i cili ka vendosur masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” për të.

8. Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, AKM me e-mail-in datë 24.02.2022, dërgoi dokumentacionin e kërkuar lidhur me procedurën e zhvilluar nga komisioni disiplinor për dhënien e masës disiplinore ndaj ankuesit, si dhe provat përkatëse në të cilat është mbështetur.
9. Me e-mail-in datë 14.06.2022, ankuesi vuri në dispozicion të Komisionerit një kopje të kërkesë padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me objekt: *“a) Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 02, datë 31.01.2022, Akti Nr. 665 Prot., datë 31.01.2022 të Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ose shfuqizmin e Vendimit Nr. 02, datë 31.01.2022, Akti Nr. 665 Prot, datë 31.01.2022 të Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ dhe informacionit të dhënë, rezulton se ankuesi është punonjës i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Aktualisht ai mban detyrën Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, në të cilën është emëruar më datë 25.06.2020 nga Departamenti i Administratës Publike.

Në prag të fushatës së Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë që u mbajtën më datë 25.04.2021, institucioni i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, me Urdhrin e Brendshëm Nr. 3, datë 24.02.2021, ngriti Grupin e Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civil gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, më datë 23.03.2021, me anë të e-mail-it ka njoftuar ARM-në Fier/Vlorë/Gjirokastrë duke i sqaruar se nga data 25.03.2021, çdo ditë brenda orës 16:30, nga e hëna në të enjte dhe brenda orës 14:00 të premten, duhet të dërgonin pranë këtij institucioni aktet e konstatimit të plotësuar për punonjësit, në të cilin ata firmosin 4 (katër) herë në ditë.

Me shkresën nr. 458, datë 05.04.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil⁷, i është drejtuar institucioneve të administratës publike, ndër to edhe ARM-së Fier/Vlorë/Gjirokastrë, duke i sqaruar ndër të tjera se për shkak të rrethanave specifike në të cilat po zhvillohet procesi i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25.04.2021, si pasojë e rregullave të vendosura nëpërmjet urdhrit nr. 132, datë 08.03.2021, të Ministrit të Shëndetësisë *“Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”*, KMSHC është informuar në lidhje me shqetësimin e përdorimit të rrjeteve sociale për fushatë, nga ana e nëpunësve civil të administratës publike. Në këtë kuptim, KMSHC, ka vlerësuar se përdorimi i rrjeteve sociale për qëllime të propagandimit apo shprehjes publike të bindjeve dhe preferencave politike të nëpunësit civil, është i ndaluar.

Referuar shkresës së sipërcituar, Grupi i Monitorimit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i përbërë nga A. V. dhe 2 (dy) nëpunës të tjerë, me shkresën nr. 1725 prot., datë 11.05.2021, ka hartuar një informacion në të cilin citon ndër të tjera se: *“...Ne si grup monitorimi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, verifikuam nga ana jonë adresën në rrjetin social fotot, dhe komentet që na janë vendosur në dispozicion dhe ju bëjmë me dije se adresa e Facebook Gonifutboll Goni Futboll i përket A. B. Në momentin që hap të dhënat e llogarisë dhe shikon historikun e adresës e bën lidhjen midis adresës Gonifutboll Goni Futboll dhe A. B., me pozicion Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Gjithashtu nga verifikimi, konstatuam se komentet dhe fotot që ju kemi vënë në dispozicion janë dërguar nga miq të përbashkët me nëpunësin në fjalë. Ku ka shprehur hapur bindjet dhe preferencat e tij politike gjatë periudhës së monitorimit, në rrjetin social facebook në adresën Gonifutboll Goni Futboll, duke shkelur nenin 37, pika 1 të ligjit 152/2013. Adresa është lehtësisht e verifikueshme sepse A. B. në këtë adresë ka shokë të përbashkët një pjesë të stafit aktual dhe të ISHMPUT.”*

Me shkresën nr. 1725/1 prot., datë 12.05.2021, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë i është drejtuar KMSHC-së, duke i referuar për vlerësim rastin e sipërcituar të A. B.

Përsa më sipër, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i është drejtuar AKM-së me shkresën nr. 2405 prot., datë 22.06.2021, për ngritjen e Komisionit Disiplinor për nëpunësin civil A. B., referuar konstatimeve të Grupit të Monitorimit sa i përket adresës në rrjetin social Facebook *“Gonifutboll Goni Futboll”*. Evidentohet se nga ana e AKM-së nuk u ndërmorr asnjë hap për vlerësimin e situatës së paraqitur nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, sa i përket ngritjes së Komisionit Disiplinor për nëpunësin civil A. B.

Në përgjigje përsa sipërcituar, KMSHC me shkresën nr. 458/4 prot., datë 30.06.2021, i është drejtuar ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Komisioneri çmon se Grupi i Monitorimit të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë është organi*

⁷ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMSHC

kompetent i cili duhet të verifikojë dhe të vlerësojë veprimet e kryera nga nëpunësi civil A. B. dhe në rast se do të gjykojë se këto veprime vijnë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të adresojë rastin pranë organit kompetent, për ndjekjen e procedurave të mëtejshme disiplinore...Nga analiza e akteve të konstatimit të mbajtura nga grupi i monitorimit i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë për periudhën e fushatës zgjedhore, është konstatuar mosprezenca në punë e nëpunësit A. B.. Konkretisht, rezulton se në akt-konstatimin e datës 15.04.2021, grupi i monitorimit ka evidentuar mungesën e tij, duke shënuar përbri emrit “mungesë”. Në lidhje me mungesën e konstatuar, grupi i monitorimit ka informuar nëpërmjet komunikimit elektronik, se nëpunësi A. B. nuk ka paraqitur asnjë dokument që të materializojë shkakun ligjor të mosparaqitjes në punë...grupi i monitorimit në bashkëpunim me eprorin direkt të nëpunësit A. B. duhet të shqyrtojë nëse mungesa e pajustifikuar e këtij nëpunësi përbën shkelje disiplinore dhe nëse do të vlerësohet si e tillë, të marrë masa për fillimin e ecurisë disiplinore...”.

Referuar dokumentacionit të administruar⁸, më datë 08.09.2021 ndërmjet ankuesit dhe A. V. në ambientet e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, ka ndodhur një konflikt fizik. Në vijim, ankuesi është paraqitur në Spitalin Rajonal Fier për të marrë trajtim mjekësor. Gjithashtu, rezulton se në të njëjtën datë, ankuesi ka depozituar kallëzim penal pranë Komisarariatit të Policisë Fier, ndaj eprorit të tij, A. V.

Po në datën 08.09.2021, nga ana e A. V. dhe disa punonjësve të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë është mbajtur Procesverbal nr. 3295 prot., datë 08.09.2021, në të cilin është përshkruar konflikti i ndodhur ndërmjet ankuesit dhe A. V.

Në vijim përsa sipërcituar, A. V. i është drejtuar AKM-së duke kërkuar sërish ngritjen e Komisionit Disiplinor për A. B., duke pretenduar se ankuesi ka shkelur:

- Nenin 37, pika 1 të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, ku citohet: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike”.*
- Nenin 57, pika 2, gërma c), e Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, ku citohet: *“Moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale”.*
- Nenin 57, pika 3 gërmat c), ç), dh), ku citohet: *“Shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil”; “Sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun”; “Kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, e veprimeve që çënojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi”.*

⁸ Procesverbalit nr. 3295, datë 08.09.2021, të në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë

- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 *“Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”*, Neni 3 gërma ç) *“Të jetë i sjellshëm në mardhënie me qytetarët që ju shërben dhe me eprorët, kolegët dhe vartësit të tij”*.
- Nenin 7, pika 1 e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 *“Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”*, ku citohet: *“Nëpunësi publik nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij që e bën të vështirë kryerjen e detyrës, ose është vazhdim i kësaj detyre, që cënon, në çfarëdo mënyre, imazhin e nëpunësit të administratës publike”*.
- Nenin 14 *“Koha e punës”*, ku citohet se: *“Nëpunësi duhet ta përdorë kohën e punës në mënyrë efektive për detyrat zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.
- Nenin 9 *“Masat disiplinore”*, ku citohet se: *“Nëpunësit që shkelin parimet e etikës, të përcaktuara në këtë ligj, kur veprimet tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore, sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin për statusin e nëpunësit civil”*.

Referuar kërkesës së përsëritur të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me Urdhrin Nr. 141, datë 24.09.2021, urdhëroi ngritjen e Komisionit Disiplinor, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, për punonjësin A. B. Me shkresën Nr. 2865/1 prot., datë 24.09.2021, Komisioni Disiplinor i ngritur me Urdhërin nr. 141, datë 24.09.2021, njoftoi ankuesin për të paraqitur me shkrim sqarimet rreth shkeljeve të pretenduara, në seancën që do të mbahej më datë 30.09.2021, pranë AKM-së.

Përsa më sipër, në datën 27.09.2021, ankuesi është njoftuar me e-mail nga Përgjegjësjë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, se në datën 30.09.2021 duhet të paraqitej në ambientet e AKM-së. Nga informacioni i dhënë nga ankuesi, ai ka kundërshtuar si të paligjshëm përbërjen e komisionit. Pas ankesës së tij, është njoftuar në datën 11.10.2021 me e-mail nga Përgjegjësjë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKM, për zhvillimin e procedurës në datën 15.10.2021.

Në përfundim, në datën 07.12.2021, ankuesi është njoftuar me e-mail nga përfaqësuesit e AKM-së se seanca e radhës së Komisionit Disiplinor do të zhvillohej në datën 14.12.2021.

Pas përfundimit të procedurës administrative, ankuesi me anë të e-mail-it është vënë në dijeni të Vendimit Nr. 02, datë 31.01.2022, të Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit i cili kishte vendosur: *“Të japë masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”, në zbatim të gërmës “c” të nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ndaj A. B., me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, për shkeljen e konstatuar sipas arsytimit në këtë vendim. Komisioni Disiplinor*

gjatë arsyetimit ka konstatuar shkelje, sa i përket vetëm moskryerjes së detyrave funksionale të ngarkuara nga eprori direkt”.

A 1. *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim, sa i përket konfliktit fizik të ndodhur mes tij dhe shtetasit drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, A. V..*

Në referim të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, vërehet se pretendimet e për diskriminim nga ana e ankuesit, lidhen me faktin e konfliktit fizik të ndodhur mes tij dhe shtetasit A. V.. Në këtë kuadër, subjekti ankues, referuar konfliktit fizik të sipërcituar, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier me një kallëzim kundër eprorit të tij, A. V., fakt për të cilin ka vënë në dijeni edhe Komisionerin.

Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në nenin 148, pika 1, parashikon se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*”

Për sa më sipër, rezulton se Prokuroria është përgjegjëse në ndjekjen e veprave penale, në territorin e juridiksionit të saj.

Referuar për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kryerja e veprimeve arbitrare, nga punonjës që ushtrojnë një funksion shtetëror ose një shërbim publik, parashikohet si vepër penale në nenin 250 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Në nenin 250, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “*Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet*”.

Gjithashtu, në nenin 90 të Ligjit Nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: “*Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.*”

Neni 50, i Ligjit Nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në të cilin parashikohen Rrethanat rënduese, në gëmën j), parashikon se: “*Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë:*

j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket “*dhunës së ushtruar nga shtetasi A. V. për motive të bindjeve politike*”, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e pretendimit për diskriminim, sa i përket konfliktit fizik të ndodhur mes tij dhe shtetasit drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, A. V., por do ndjekë procedurat ligjore lidhur me pretendimin për diskriminim, sa i përket procedurave të dhënies së masës disiplinore dhe trajtimin në vendin e punës.

A 2. Lidhur me dhënien e masës disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*” nga ana e Komisionit Disiplinor të AKM-së.

Me shkresën nr. 2405 prot., datë 22.06.2021, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i është drejtuar AKM-së, për ngritjen e Komisionit Disiplinor për ankuesin, referuar konstatimeve të Grupit të Monitorimit sa i përket adresës në rrjetin social Facebook “*Gonifutboll Goni Futboll*”. Nga ana e AKM-së nuk u ndërmorr asnjë hap për vlerësimin e situatës së paraqitur nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, sa i përket ngritjes së Komisionit Disiplinor për nëpunësin civil A. B..

Referuar shkresës së ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë nr. 3302 prot, datë 09.09.2021 “*Kërkesë për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, AKM ka njoftuar ankuesin me shkresën nr. 2865/3 prot., datë 18.01.2022, për pjesëmarrje në Komisionin Disiplinor dhe shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara.

Me Urdhërin nr. 10, datë 18.01.2022 të AKM-së “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecuresë disiplinore, në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë*”, është urdhëruar ngritja dhe përbërja e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecuresë disiplinore ndaj punonjësit A. B..

Me Vendimin nr. 02, datë 31.01.2022, Komisioni Disiplinor i AKM-së, ka vendosur:

1. *“Të japë masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”, në zbatim të gërmës “c” të nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ndaj A. B., me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, për shkeljen e konstatuar sipas arsyetimit në këtë vendim”.*
2. ...
3. ...
4. *Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit”.*

Komisioni Disiplinor gjatë arsyetimit ka konstatuar shkelje, sa i përket vetëm moskryerjes së detyrave funksionale të ngarkuara nga eprori direkt në kohë dhe me cilësi.

Në referim të procedurës së masës disiplinore, rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për fillimin e procedurës disiplinore në datë 08.11.2021 në rrugë shkresore dhe me anë të e-mail-it, si dhe i ishte lënë afat për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij deri më datë 12.11.2021. Në këtë rast Komisioneri vlerëson se ankuesit i është lënë koha e mjaftueshme, prej jo më pak se 4 ditë, siç është parashikuar në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014, për të përgatitur mbrojtjen dhe për të paraqitur shpjegimet e tij, lidhur me shkeljen e pretenduar nga punëdhënësi.

Në shqyrtim të parashikimit të mësipërm, vlerësohet se AKM ka respektuar afatin e parashikuar në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014, për të njoftuar ankuesin për datën se kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Për shkak se ankuesi ka qenë me Raport Mjekësor, ai është njoftuar së fundmi më datë 18.01.2022, për tu paraqitur më datë 24.01.2022, pranë Komisionit Disiplinor për realizimin e seancë dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor, ankuesi ka paraqitur në rrugë shkresore por edhe verbale parashtrimet e tij⁹. Gjithashtu, me anë të e-mail-it datë 14.06.2022, të dërguar pranë KMD-së, ankuesi ka njoftuar se ka ndërmarrë veprime për ta kundërshtuar në gjykatë, ashtu siç parashikohet në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014.

Në nenin 59 të Ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, parashikohen kompetencat dhe procedura për masat disiplinore. Në këtë nen përcaktohet se:

2. *Masat disiplinore të parashikuara në shkronjët “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58¹⁰ të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.*

⁹ Sipas informacionit të dhënë gjatë seancës dëgjimore të mbajtur pranë Komisionerit.

¹⁰ b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet. ç) largim nga shërbimi civil.

3.

4. Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil;

Në VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se:

Kreu I, pika 2: “Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje: a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin; b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; ç) një përfaqësues të DAP-it; d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore”.

Në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, përcaktohet në mënyrë të detajuar detyrat dhe procedurat e Komisionit Disiplinor. Në këtë udhëzim përcaktohet se vendimi i këtij organi disiplinor ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

Në analizë të legjislacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se Komisioni Disiplinor është ngritur dhe ka zhvilluar procesin e shqyrtimit të masës disiplinore sipas parashikimeve të sipërcituara, duke zbatuar procedurën dhe duke i dhënë mundësinë ankuesit për tu mbrojtur dhe për të dhënë shpjegimet e tij. Në përfundim, Komisioni Disiplinor pasi ka vlerësuar faktet e paraqitura nga ankuesi, ka bërë shqyrtimin e masës disiplinore dhe hetimin administrativ, lidhur me mungesat e pajustificuara dhe mospërmbushjes së detyrave funksionale, dhe ka marrë vendimin për dhënien e masës disiplinore për A. B., në zbatim të pikës “c” të nenit 58 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Me anë të e-mail-it datë 14.06.2022, ankuesi ka përcjell pranë Komisionerit, kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kundërshtuar Vendimin Nr. 02, datë 31.01.2022 të AKM-së. Ankuesi i është drejtuar gjykatës për të ankimuar masën disiplinore, sipas parashikimit të bërë në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, i cili përcakton se vendimet e këtyre organeve disiplinore ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

Ankuesi theksoi gjatë seancës dëgjimore se për të gjitha pretendimet e ngritura nga ana e drejtuesit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, ai është njohur më datë 21.10.2021 dhe nuk e kishte informacionin për të kundërshtuar argumentat e parashtruar nga përfaqësuesit e komisionit.

Gjithashtu, ankuesi theksoi se komisioni disiplinor nuk e mori parasysh këtë fakt dhe vijoi me dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Në analizë të këtij pretendimi, Komisioneri vlerëson se ai nuk qëndron, pasi nga data 21.10.2021 kur ankuesi pretendon se ka marrë dënimin, deri ditën e realizimit të seancës datë 24.01.2021, ankuesi kishte rreth 3 (tre) muaj afat për të kundërshtuar apo hedhur poshtë argumentat e ARM-së Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është cënuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai ka patur të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në lidhje me arsyet e dhënies së masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”*.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja e marrë nga Komisioni Disiplinor i AKM-së, rezultojnë të ligjshme në përfundim të një procesi të rregullt ligjor.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja nga Komisioni Disiplinor, rezultojnë të marrë në përfundim të një procesi të rregullt ligjor. Sa i përket faktit nëse masa disiplinore e dhënë ndaj tij është e mbështetur në fakte dhe prova, është një proces që po ndiqet aktualisht nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Komisioneri nuk ka kompetencë në shqyrtimin e saj.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se për sa i përket dhënies së masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”*, A. B. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e eprorit direkt apo AKM-së. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

A 3. *Lidhur me pretendimin e ankuesit për tërheqjen e vëmendjes nga ana e drejtuesit të institucionit, për shkelje të rregullave të etikës, moskryerjen e detyrave, mungesës në punë, nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.*

Referuar kronologjisë së dhënies së njoftimeve për tërheqje vëmendje në ngarkim të ankuesit nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, rezultojnë se ndaj A. B. kanë dalë shkresat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 1902 prot., datë 14.10.2020, *“Tërheqje vëmendje”*, A. V., i është drejtuar ankuesit dhe 3 (tre) punonjësve të tjerë lidhur me respektimin e orarit zyrtar të punës. Nga ana e ankuesin nuk rezultojnë të jetë kundërshtuar shkresërisht.
- Me akt konstatimin nr. 981 prot., datë 15.04.2021, *“Në lidhje me prezencën në punë të nëpunësve civil”*, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka përcjellë pranë KMSHC-së informacionin për mungesën pa arsye në punë të ankuesit gjatë fushatës zgjedhore.
- Me shkresën nr. 2405 prot., datë 22.06.2021, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i është drejtuar AKM-së, për ngritjen e Komisionit Disiplinor për ankuesin, referuar konstatimeve të Grupit të Monitorimit sa i përket adresës në rrjetin social Facebook *“Gonifutboll Goni Futboll”*.

- Me procesverbalin Nr. 3492/1 prot., datë 01.10.2021 dhe Urdhrin e Brendshëm Nr. 31, datë 01.10.2021 “Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”, A. V. i është drejtuar Sektorit të Financës për ndërprerjen e ditës së punës për ankuesin, pasi gjatë kontrollit të ushtruar prej tij, ankuesi nuk është gjendur në ambientet e zyrave të institucionit. Nga listëprezenca e vënë në dispozicion nga ankuesi, rezulton se ai ka firmosur atë në orën 08:00; 12:00 dhe 14:00.
- Gjatë periudhës 04.10.2021-29.10.2021 dhe në datën 12.01.2022, janë mbajtur nga A. V. disa procesverbale në të cilat citohet fakti që ankuesi për një pjesë të detyrave të ngarkuara nuk i ka realizuar në kohë dhe brenda kërkesave. Në 2 (dy) prej procesverbaleve është evidentuar se detyrat e ngarkuara nga A. V. nuk janë realizuar edhe nga 8 (tetë) punonjës të tjerë të ARM-së Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

Marrëdhëniet e punës së ankuesit, si nëpunës civil, janë rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në nenin 59 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat dhe procedura për masat disiplinore. Në këtë nen përcaktohet se:

1. “Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a”¹¹ të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil...
7. Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.....

Në VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se:

Kreu II, pika 1: “Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkelje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor”.

Komisioneri vlerëson se procesverbalet e mbajtura nga ana e drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë dhe tërheqja e vëmendjes, me anë të të cilave janë konstatuar mosrealizimi i detyrave nga ankuesi edhe pse janë mbajtur disa herë për të dhe nëpunës të tjerë të institucionit, nuk është masë apo nisje e ecurisë disiplinore e parashikuar as në ligjin për nëpunësin civil dhe as në rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Ajo

¹¹ a) vërejtje;

mund të shërbejë si element i procedimit disiplinor, por nuk është masë disiplinore në vetevetë, pasi nuk parashikohet si e tillë.

Referuar dokumentacionit të dosjes personale të ankuesit dhe mbështetur në provat dhe informacionin e administruar nga palët në proces, rezulton se A. B. që nga momenti i emërimit pranë ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, më datë 25.06.2020, nuk ka pasur masa disiplinore. Gjithashtu, referuar formularit të vlerësimit të nëpunësit civil, A. B., të periudhës 01.07.2020 deri 30.06.2021, rezulton se ai është vlerësuar me rezultatin “Mirë¹²” nga ana e drejtuesit të institucionit, A. V. dhe konfirmuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së. Në formularin e vlerësimit të punës, ankuesi është vlerësuar “mirë” lidhur me, gabimet/saktësia në punën e kryer, realizimin në kohë të punës dhe kolegjaliteti i marrëdhënieve-marrëdhënia me kolegët. Në këtë formular të vlerësuar nga A. V. nuk evidendohet fakti se ankuesi ka pasur vështirësi në të kuptuarit dhe zbatimin e detyrave. Ky vlerësim është evidentuar në vlerësimin e punës të 6-mujorit të parë të vitit 2021.

Referuar realizimit të detyrave të kërkuara dhe cilësisë së tyre, rezulton se ankuesi pas konfliktit të ndodhur më datë 08.09.2021, gjatë periudhës që ai ka qenë me Raport Mjekësor, kompjuterin e tij ia ka lënë në përdorim¹³ një punonjëseje tjetër të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Në momentin e rikthimit në punë nuk ka patur kompjuter në përdorim. Referuar e-mail-it datë 27.10.2021 dhe shkresës nr. 3816 prot., datë 27.10.2021, ankuesi ka kërkuar të pajiset me kompjuter. Rezulton që nga ana e A. V., ankuesi është vënë në dijeni nëpërmjet e-mail-it të dërguar specialistes S. J., të sektorit ku A. B. është përgjegjës, duke i sqaruar ndër të tjera se: “...Sektori juaj aktualisht jeni dy punonjës dhe keni qenë gjithë kohën me dy kompjutera, si anjë sektor tjetër dhe përsëri detyrat nuk janë realizuar në kohë dhe as me cilësi. Aktualisht kompjuteri në zyrën e monitorimit është bosh pasi specialistja V. G. është me leje të zakonshme...”.

Mospajisja e të gjithë punonjësve me mjete elektronike (kompjuter/laptop) për të kryer detyrat e parashikuara dhe të ngarkuara nga eprori, është fakt i njohur edhe nga e-maili i sipërcituar por është pranuar edhe nga drejtuesi i institucionit, gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit të ankesës Nr. 108, datë 10.06.2021, të paraqitur nga G.Zh., kur deklaroi¹⁴ se: “..ka një zyrë inspektorësh me 10 punonjës që kanë 3-4 kompjuter, zyrë me 7 punonjës që kanë 2 kompjuter dhe zyrë me 1 laptop”. Në këtë aspekt mospajisja e infrastrukturës së nevojshme nga ana e punëdhënësit, për të siguruar mjetet e duhura punonjësve për realizimin e detyrave, vlen për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm për A. B.

Përsa më sipër, tërheqja e vëmendjes së punonjësve nga ana e eprorit direkt, apo nisja e një procedure disiplinore është një proces i cili është ndjekur edhe në raste të tjera për të cilat

¹² Mirë (2) Nëpunësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë.

¹³ Referuar informacionit të dhënë nga ankuesi gjatë seancës dëgjimore në KMD.

¹⁴ Referuar min 53.30 të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e ankesës Nr. 108, datë 10.06.2021, të paraqitur nga G.Zh., pranë KMD-së.

Komisioneri është vënë në dijeni gjatë ankesës në fjalë, por edhe ankesës nr. 108, datë 10.06.2021, të shqyrtuar më parë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenin nenin 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A. B., nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)